



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1643/ 7 prot.

Datë 10.07.2025

V E N D I M
Nr. 881/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2025 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Albania Motor Company*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt Loti 2 “*Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit*” me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Albania Motor Company*” SHPK me NIPT K41829010I me adresa: Kashar, Mezez, Autostrada Tiraneë - Durres, km 2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka mangësi, nuk është sipas formularit përkatës si dhe nuk është dorëzuar mandatpagesa, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.04.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt Loti 2 “Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 28.05.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 18.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët

ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albania Motor Comapany” SHPK	171,360,000 lekë skualifikuar
2. “Porsche Leasing” SHPK	194,754,240 lekë skualifikuar
3. “Mektrin Motors” SHPK	201,024,000 lekë kualifikuar
4. “Tirana Auto” SHPK	204,480,000 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 18.06.2025, operatori ekonomik “Albania Motor Comapany” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet se:

- *Operatori ekonomik Albania Motor Company sh.p.k. (AMC), nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim në lidhje me kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.1 dhe 2.3.7 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” për këto arsye:*

I) Nuk plotëson pikën 2.3.1 për shërbimet e ngjashme në tre vitet e fundit të aktivitetit. Për plotësimin e këtij kriteri, OE “Albania Motor Company” sh.p.k., ka paraqitur 72 fatura tatimore shitje të automjeteve të tipit “Ford KUGA” me vlere totale 155,181,744 leke pa TVSH. Keto fatura kane si objekt “shtiblerje automjesh” dhe ato nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit “shërbimi i dhënies me qera të automjeteve ose leasing operacional”. KVO argumenton se referuar legjislacionit sipas Kodit Civil shitblerja nuk mund të konsiderohet e ngjashme me qerane. Shitblerja eshte nje veprim juridik ku shitesit i humbet e drejta e sendit ne favor te blerësit pasi ky i fundit paguan vlerën e plotë të sendit, ndërsa në rastin e qeradhënies pronësia i mbetet shitësit të shërbimit i cili ka detyrimin të mirëmbajtjes në mënyrë të vazhdueshme sendin përkudrejt pagesës të një shume mujore nga blerësi i shërbimit. Gjithashtu edhe referuar këtij prokurimi objekti i kësaj kontrate “dhënia me qera operationale e automjeteve” nuk është absolutisht e ngjashme me shitblerjen e automjeteve pasi (Policia e Shtetit) ka vendosur si kusht se ofertuesi duhet të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të automjeteve që Policia e Shtetit do të marrë me qera duke disponuar madje kapacitetet teknike te nevojshme (disponimi i një servisi për mirëmbajtjen dhe riparimet) për këtë qëllim. Pra shitblerja e automjeteve nga Albania Motor Company nuk është e ngjashme me “shërbimin e dhënies me qera të automjeteve” dhe Albania Motor Company sh.p.k, nuk e plotëson kërkesën për vërtetimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit .

II) Nuk plotëson pikën 2.3.7, kapacitetet teknike për diponimin e një servisi për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Referuar pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim kërkohet: 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- *Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).*

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhte të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

Argumentimi i Njesisë të Prokurimit: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në specifikimet teknike ku përfshihen kryerja e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve dhe kryerja e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së punës operacionale.

Arsyetimi i KVO.

Pra në bazë të kërkesës për kualifikim Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kusht për kualifikim disponimin e një ambient servisi të automjeteve, disponim i cili vërtetohet në dy mënyra:

- 1. Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera të një servisi të riparimit të automjeteve.*
- 2. Lidhja e një kontrate të vlefshme me një subjekt i cili disponon një servis të riparimit të automjeteve.*

Konkretisht, OE “Albania Motor Company” sh.p.k, ka paraqitur kontratën Nr.1163 Rep, Date 27.05.2025, marrje me qera pasuri e paluajtshme qera truall 5000 m2 dhe ndertese 2160 m2 nga subjekti Safe Security Albania sh.p.k. Kontrata ne Nenin 2 përcakton se ambienti do të përdoret për servis dhe shitje automjeteve mirëpo dokumenti nuk ka të dhëna nëse ambienti përmban një servis të automjeteve në pronësi të OE “Albanian Motor Company”. KVO gjithashtu kontrollon në regjistrin publik on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit nga ku rezultoi se:

- Subjekti që ka dhënë ambientin me qera, shoqëria “Safe Security Albania” sh.p.k nuk disponon liçense për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve.*
- Subjekti ofertues “Albania Motor Company” sh.p.k nuk disponon liçense të vlefshme për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve. Liçensa LN-5474-07-2018, rezulton se nuk është aktive dhe se i ka skaduar afati në datën 09.07.2023. Pra, referuar dokumentacionit publik në QKB rezulton se ofertuesi nuk disponon servis automjeteve në momentin e hapjes dhe vleresimit të ofertave.*

Për këto arsye, referuar kërkesës për kualifikim në dokumentat e tenderit ku kërkohet shprehimisht që ofertuesi duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së

kontratës, sipas specifikimeve teknike, rezulton se OE “Albania Motor Company” sh.p.k, në momentin e hapjes dhe vlerësimit, nuk vërtetohet se disponon një servis për shërbimin dhe riparimin e automjeteve, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit.

II.5. Në datën 23.06.2025, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim - Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “Mektrin Motors” SHPK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.06.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5466 dhe me nr. 1643/2025 prot, datë 24.06.2025, e operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK, por nga verifikimi i sistemit të ankesave elektronike nuk rezulton që ky operator të ketë ngarkuar me attach në versionin pdf ankesën sipas formatit të duhur ligjor dhe mandat për kryerjen e pagesës për ankesën në fjalë, nga verifikimi i seksionit përshkrimi i ankesës të sistemit të ankesave elektronike rezulton se ky operator ekonomik ankimues kërkon shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt – ankimi si më poshtë vijon:

Baza ligjore e ankesës LIGJ Nr. 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK KREU XIV ANKIMI ADMINISTRATIV

Objekti i ankesës	Shënime
Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj	

Rezultatet dhe faktet Nisur nga njoftimi të fituesit me datë 18/06/2025 për procedurën e prokurimit publik me Numri i Referencës së Lotit 2: REF-46106-04-25-2025 dhe objekt kontrate: Loti 2: “Marje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” nga autoriteti kontraktor “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara”, “Albania Motor Company” Sh.p.k kundërshton refuzimin e ofertës nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkrimi i shkeljeve të pretenduara Referuar argumentimit tuaj të skualifikimit si më poshtë:
“KVO argumenton se referuar legjislacionit sipas Kodit Civil, shitblerja nuk mund të konsiderohet e ngjashme me qerane. Shitblerja është një veprim juridik ku shitësit i humbet e drejta e sendit në favor të blerësit pasi ky i fundit paguan vlerën e plotë të sendit, ndërsa në rastin e qeradhenies pronësia i mbetet shitësit të shërbimit i cili ka detyrimin të mirembaje në mënyrë të vazhdueshme sendin kundrejt pageses të një shume mujore nga blerësi i shërbimit.”
Si dhe DST shtojka 8 Kriteret e Vecanta pika 2.3.1 është kërkuar si më poshtë:
b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatorit ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi juaj bie në ndesh me kërkesat e DST e cila kërkon Faturat Tatimore të shitjes në sektorin privat. Në rast se do të kërkohej Faturat e dhenies me qera, Albania Motor Company do të bashkalidhte këto fatura në këtë procedurë. Argumentimi juaj për skualifikimin e Albania Motor Company nuk qëndron dhe bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Neni 114 Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor pika 3. a) pranimin e plotë të ankesës dhe kualifikimin e Albania Motor Company.
Më poshtë do të gjëni referencat e faturave në sektorin privat me referencë “Faturime_72_x_mjete”. Sa më sipër KVO nuk mund të bëjë interpretime të cilat janë të pa kërkuara në DST nga njesia e hartimit të dokumentave të kësaj procedure. Interpretimet e KVO janë në kundërshtim me rregullat dhe ligjin e Prokurimit Publik, dhe behen me qëllimin e vetëm për të favorizuar një operator të vetëm ekonomik i cili është fitues të dy loteve.

Albanian Motors Company kërkon nga komisioni i shqyrtimit të ankesave pranimin e ankesës sone për këtë pikë.

Pretendimi I Operatorit Ekonomik:

Bazuar në argumentimin e paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), sipas të cilit pretendohet se kompania "Albania Motor Company" nuk disponon servis automjeteve, kjo pretendueshmëri nuk qendron. Në kontratën për punë të ngjashme të dorezuar dhe në Lotin 1 midis AK "Drejtorise se Pergjithshme të Policise se Shtetit" dhe BOE "Albania Motor Company" & "Antigone Rentals", në dokumentacionin e dorezuar gjendet e bashkëlidhur "Deklarata e Servisit të Autorizuar", e cila është hartuar në përputhje me kushte teknike edhe më të detajuara. Këto kushte janë përbushur në mënyrë të plotë dhe rigoroz nga kompania "Albania Motor Company". Gjithashtu, në këtë kontratë paraqiten pamje të qarta që vërtetojnë se kompania disponon servis in e saj të automjeteve. Nga ana e Albanian Motor Company është paraqitur dhe kontrata e qerese ku ne ushtrojmë aktivitetin, si për shitjen e makinave, dhenien me qera dhe servis in e tyre.

Bazuar në Ekstraktin Historik të QKB në rubriken 9 "Objekti i aktivitetit" të shoqërisë Albania Motor Company evidentohet qarte dhenia me qera dhe ofrimi i servis it me të gjithë komponentet e tij. Kontrata e qerese e paraqitur nga ana jone është pikerisht prona ku Albania Motor Company ushtron aktivitetin, ku ka të përfshirë dhe servis in. Pavaresisht këtyre fakteve të paraqitura nga ne, KVO për të dale në një konkluzion sa më të qarte, duhet të verifikonte në vend servis in para se të dilte në një konkluzion skualifikimi i cili rëndon buxhetin e shtetit me një vlerë prej afro 29 milion leke të reja.

Albania Motor Company disponon servis in e autorizuar prej 21 vitesh, dhe është e pa pranueshme që pas 21 viteve eksperince të sukseshme, duke ofruar shërbime për institucione shtetërore dhe private në shitjen, për makinat e dhena me qera dhe të shitura prej nesh, të degjojme nga ana e KVO që nuk disponojmë servis in.

Sa më sipër me të njëjtin dokumentacion argumentues për servis in Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit na ka kualifikuar dhe kemi lidhur kontratën për marje makina me qera, ndersa po për të njëjten procedure të ngjashme, dhe po për llogari të Drejtorise se Pergjithshme të Policise se Shtetit, KVO-se për KVO nuk plotësojmë kriteret.

Më poshtë do të gjeni dhe pjesë nga Ekstrakti Historik i QKB në rubriken 9. "Objekti i aktivitetit".

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Neni 114 Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor pika 3. a) pranimin e plote të ankesës dhe kualifikimin e Albanian Motor Company.

Albanian Motors Company kërkon nga komisioni i shqyrtimit të ankesave pranimin e ankesës sone për këtë pikë

Në Ekstraktin Historik të QKB që kompania ka vënë në dispozicion është e shprehur qarte ofrimi i shërbimeve. Në faqen nr.1 pika 9 Objekti i aktivitetit :qiramarrjen apo qiradhenien , gjithashtu dhe në faqen nr.2 pika 9 Objekti i aktivitetit: Riparim automjeteve të të gjitha llojeve përfshirë kamionë dhe mjetet e rënda të punës, mirëmbajtjen dhe kontrollin teknik të automjeteve të ndryshme, përfshirë automobilat, kamionët, traktorët, ekskavatorët, autobusët dhe mjetet e tjera të transportit, si dhe riparimin e sistemeve motorike, të frenimit, elektrike, hidraulike, mekanike, të drejtimit dhe të ngjashme. Shërbime për lyerjen e automjeteve të të gjitha llojeve, përfshirë përdorimin e teknologjive moderne të lyerjes, riparimin e dëmeve të karrocierisë, trajtimin e sipërfaqeve të ndryshme të automjeteve, si dhe përdorimin e bojërave dhe materialeve

Skualifikimi jone është bërë për të favorizuar po të njëjten kompani si në Lotin 1 ashtu dhe në Lotin 2 ku pavaresisht se ka ndryshuar emrin ka po të njëjtet Aksionere. Duket qarte se KVO nuk ka vlerësuar duke u bazuar në dokumentacionin ligjor por në cmimin me të lartë. Demi Ekonomik i shkaktuar shteti dhe taksapaguesve Shqipëtar në të dy procedurat është afro 57 milion leke të reja.

KVO duhet të konstatojë faktin se I njëjti prodhues ka marrë pjesë në këtë procedure prokuruese me dy kompani të ndryshme ku në vend se të skualifikonte të dy kompanitë, në kundërshtim të hapur me ligjin ka kualifikuar njërin, duke e shpallur dhe fitues.

Më keqardhje konstatojmë faktin se vlersimi për këtë procedure prokuruese nga anëtarët e KVO, ka qenë i njëanshem dhe fituesi ka qenë i paracaktuar.

Nga KVO janë shkelur Nene të Kodit Penal, Neni 248 "Shpërdorimi i Detyres", Neni 258 "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankandë publike" dhe Neni 25 "Kuptimi i bashkëpunimit"

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 3. "Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrëmbërojnë konkurrencën;" ku MEKTRIN MOTORS dhe PORSCHE LEASING kanë autorizim prodhuesi nga i njëjti prodhues për Lotin 1 dhe Lotin 2 .

Sa më sipër duke konstatuar me keqardhje se të gjithë anëtarët e KVO duke na skualifikuar, kanë shkelur hapur barazinë e pjesëmarrësve në tendera apo ankandë publike duke shpërdoruar detyrën. Sa më sipër Albanian Motor Company do të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të vënë para përgjegjësisë ligjore personat që kanë shpërdoruar detyrën në këtë procedure prokuruese.

Sa më sipër bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Nr.162 datë 23/12/2020 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" kërkojmë pranimin e plote të ankesës dhe kualifikimin si oferte të sukseshme e Albania Motor Company për këtë procedure prokuruese.

Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☒

Specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte Te Verifikohet nga një ekspert i fushës pjesë e disponueshmërisë së Servisit prane ambienteve të Albania Motor Company

Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do merren me shqyrtimin e ankesës

Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve N/A

Lista e informacionit konfidencial

Lista e informacionit konfidencial N/A

Keni paraqitur paraprakisht ankesë pranë Autoritetit Kontraktor?

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 dhe 4/b të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të

publikimit nr. 1643/1 prot., datë 25.06.2025, u publikuan arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” SHPK, kundërshton nëpërmjetë ankesës nr. 1643/2025, datë 24.06.2025.

II.8. Më shkresën nr. 1198/12 prot, datë 02.07.2025 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Motor Company” shpk, lidhur me vleresimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-46106-04-25-2025, me objekt Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1643/2 prot, datë 03.07.2025, rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës, nga verifikimi i së cilës rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues nuk është pranuar me argumentat si më poshtë vijon:

Ne datën 24.06.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankese nepermjet sistemit te ankesave elektronike te Komisionit te Prokurimit Publik nepermjet portalit e-Albania, prane Komisionit te Prokurimit Publik me numer protokolli 1641/2025, date 24.06.2025 dhe Nr aplikimi te ankesës online: A/2025/5464, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar qe vërteton pagesen e tarifes perkatese per ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur) si dhe nuk eshte paraqitur formulari i ankesës.

Ne nenin 111 “Paraqitja e ankeses” te ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Operatori ekonomik ankimues dergon njekohesisht ankesen ne autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik ne Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla te posame per mënyren e paraqitjes se ankeses percaktohen ne rregullat e prokurimit publik.*
- 2. Ankesa behet sipas formularit perkates, ku shenohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për proceduren konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon per shkeliet, pagesa e tarifes se ankeses, duke e shoqeruar atë me dokumentacionin dhe provat perkatese, per te cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e siperpermendura jane te domosdoshme per shqyrtimin e ankeses. Ankimuesi eshte i detyruar t'i bashkelidhe ankimit dokumentin bankar qe verteton pagesen e tarifes perkatese per ankesën.*
- 3. Nese mungon ndonje nga elementet e siperpermendura ose formulari nuk eshte plotesuar në mënyren e duhur, atehere autoriteti ose enti kontraktor duhet të vere ne dijeni ankimuesin per te plotesuar formularin. Njoftimi mund te behet me cdo mjet te mundshem, perfshire edhe posten elektronike, dhe ne cdo rast dokumentohet. Nese ankesa nuk korrigjohet brenda 2 diteve nga njoftimi, ajo vleresohet si e paparaqitur.*
- 4. Në çdo rast, paraqitja e ankeses shoqerohet me mandatpagesën e bere prane Komisionit te Prokurimit Publik.*

Referuar bazez ligjore te sipercituar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës, me anë te rubrikes “Kërkese per informacion OE” nepermjet sistemit te ankesave elektronike, ne date 25.06.2025 dergoi kerkesen per plotesimin e mangesive te konstatuara lidhur me dokumentin bankar qe vërteton pagesën e tarifes perkatese per ankesen si dhe me vete formularin e ankeses. Plotesimi i ketyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy diteve nga njoftimi.

Duke mbajtur ne konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nenshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në te cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje ne

thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit ne themel të ankimit, ne rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund te konsiderohet si ezaurim i formës se ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshem ligjore që duhet te permbajë nje ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Per sa më sipër, KSHA gjykon se perderisa operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotesoje mangesite e konstatuara lidhur me elementët permbajtësore të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

Per Këto Arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” shpk.
2. Personi përgjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi përgjegjës per prokurimin te njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites se nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje për vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëhere Titullarit te Organit Qendror Blerës.

II.9. Nga verifikimi i sistemit të ankesave elektronike konkretisht rubrikës komunikime rezulton se më datë 25.06.2025, autoriteti kontraktor, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike i është drejtuar operatorit ekonomik ankimues me kërkesë për korrigjim të metash me përmbajtje si më poshtë vijon:

Korrigjim i të metave të ankesës 25/06/2025 09:40:48 M41501042N - Operatori i Blerjeve te Pergendruara	I nderuar Operator Ekonomik "ALBANIA MOTOR COMPANY" me Nipt K41829010I, Më datë 28.04.2025 Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në cilësinë e organit qëndror blerës ka shpallur në sistemin e prokurimit elektronik të APP procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me objekt: "Marrje autovetura SUV me qira per policine e shtetit" me nr. REF-46106-04-25-2025. Më datë 24.06.2025, është administruar ankesë, në sistemin elektronik të ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5466 për procedurën e prokurimit të sipërcituar, nga ku rezulton se është paraqitur dokumentacioni shoqërues që mbështesin ankimin e tuaj por nuk është paraqitur Formulari i Ankesës ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet si dhe dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Për sa më sipër dhe referuar parashikimeve të pikës 2 dhe 3, të nenit 111 të LPP, të ndryshuar: 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. 3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur. lutemi për plotësimin e mangësisë së konstatuar mbi paraqitjen e formularit të ankesës si dhe pagesën e mandatit lidhur me ankesën e sipërpërmendur. Në rast se korrigjimet e mësipërme nuk do të bëhen brenda dy ditëve, ankesa me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5466, do të vlerësohet si e pa paraqitur. Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin
---	---

II.10. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me memon nr. 1643/3. prot, datë 08.07.2025, me objekt “Kërkesë për verifikim pagese” Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së, duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon:

Në datë 24.06.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5466 dhe me nr. 1643/2025 Prot., date 24.06.2025 e operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt Loti 2 “Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

*Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit adminisitrativ rezulton se, statusi i pagesës për ankesën me numër 1643 prot., datë 24.06.2025 rezulton “**Paparaqitur mandat pagesë**”.*

Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën me numër 1643/2025 prot., datë 24.06.2025, paraqitur nga operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.11. Më memon nr. 1643/4 prot, datë 09.07.2025 me objekt “Kthim përgjigje”, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, pas verifikimeve të kryera informon si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr.1643/3 prot., datë 08.07.2025, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.1643/2025 prot., datë 24.06.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/5466, Operatori ekonomik “Albania Motor Company” SHPK rezulton se nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.

Referuar raportit të dërguar më datë 09.07.2025 nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera për muajin Qershor- Korrik 2025, rezulton se Operatori Ekonomik “Albania Motor Company” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Albania Motor Company*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Në datën 28.04.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt Loti 2 “*Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit*” me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

III.1.2. Në datën 28.05.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt -ankimi.

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 18.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

5. “Albania Motor Comapany” SHPK	171,360,000 lekë skualifikuar
6. “Porsche Leasing” SHPK	194,754,240 lekë skualifikuar
7. “Mektrin Motors” SHPK	201,024,000 lekë kualifikuar
8. “Tirana Auto” SHPK	204,480,000 lekë skualifikuar

III.1.4. Në datën 18.06.2025, operatori ekonomik “*Albania Motor Comapany*” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsytet se:

- *Operatori ekonomik Albania Motor Company sh.p.k. (AMC), nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim në lidhje me kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.1 dhe 2.3.7 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” për këto arsye:*

I) Nuk plotëson pikën 2.3.1 për shërbimet e ngjashme në tre vitet e fundit të aktivitetit. Për plotësimin e këtij kriteri, OE “Albania Motor Company” sh.p.k., ka paraqitur 72 fatura tatimore shitje të automjeteve të tipit “Ford KUGA” me vlere totale 155,181,744 leke pa TVSH. Keto fatura kane si objekt “shtiblerje automjetsh” dhe ato nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit “shërbimi i dhënies me qera të automjeteve ose leasing operacional”. KVO argumenton se referuar legjislacionit sipas Kodit Civil shitblerja nuk mund të konsiderohet e ngjashme me qerane. Shitblerja eshte nje veprim juridik ku shitesit i humbet e drejta e sendit ne favor te blerësit pasi ky i fundit paguan vlerën e plotë të sendit, ndërsa në

rastin e qeradhënies pronësia i mbetet shitësit të shërbimit i cili ka detyrimin të mirëmbajtje në mënyrë të vazhdueshme sendin përkudrejt pagesës të një shume mujore nga blerësi i shërbimit. Gjithashtu edhe referuar këtij prokurimi objekti i kësaj kontrate “dhënia me qera operacionale e automjeteve” nuk është absolutisht e ngjashme me shitblerjen e automjeteve pasi (Policia e Shtetit) ka vendosur si kusht se ofertuesi duhet të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të automjeteve që Policia e Shtetit do të marrë me qera duke disponuar madje kapacitetet teknike te nevojshme (disponimi i një servisi për mirëmbajtjen dhe riparimet) për këtë qëllim. Pra shitblerja e automjeteve nga Albania Motor Company nuk është e ngjashme me “shërbimin e dhënies me qera të automjeteve” dhe Albania Motor Company sh.p.k, nuk e plotëson kërkesën për vërtetimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit .

II) Nuk plotëson pikën 2.3.7, kapacitetet teknike për disponimin e një servisi për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Referuar pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim kërkohet: 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

Argumentimi i Njësisë të Prokurimit: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në specifikimet teknike ku përfshihen kryerja e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve dhe kryerja e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së punës operacionale.

Arsyetimi i KVO.

Pra në bazë të kërkesës për kualifikim Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kusht për kualifikim disponimin e një ambient servisi të automjeteve, disponim i cili vërtetohet në dy mënyra:

1. Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera të një servisi të riparimit të automjeteve.

2. Lidhja e një kontrate të vlefshme me një subjekt i cili disponon një servis të riparimit të automjeteve.

Konkretisht, OE “Albania Motor Company” sh.p.k, ka paraqitur kontratën Nr.1163 Rep, Date 27.05.2025, marrje me qera pasuri e paluajtshme qera truall 5000 m2 dhe ndertese 2160 m2 nga subjekti Safe Security Albania sh.p.k. Kontrata ne Nenin 2 përcakton se ambienti do të përdoret për servis dhe shitje automjeteve mirëpo dokumenti nuk ka te dhena nese ambjenti permban nje servis të automjeteve në pronësi të OE “Albanian Motor Company”. KVO gjithashtu kontrollloi në regjistrin publik on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit nga ku rezultoi se:

- Subjekti që ka dhënë ambientin me qera, shoqëria “Safe Security Albania” sh.p.k nuk disponon liçense per mirembajtje dhe riparim te automjeteve.
- Subjekti ofertues “Albania Motor Company” sh.p.k nuk disponon liçense te vlefshme per mirembajtje dhe riparim te automjeteve. Liçensa LN-5474-07-2018, rezulton se nuk është aktive dhe se i ka skaduar afati ne daten 09.07.2023. Pra, referuar dokumentacionit publik në QKB rezulton se ofertuesi nuk disponon servis automjeteve ne momentin e hapjes dhe vleresimit te ofertave.

Për këto arsye, referuar kërkesës për kualifikim në dokumentat e tenderit ku kërkohet shprehimisht që ofertuesi duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike, rezulton se OE “Albania Motor Company” sh.p.k, në momentin e hapjes dhe vlerësimit, nuk vërtetohet se disponon një servis për shërbimin dhe riparimin e automjeteve, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit.

III.1.5. Në datën 23.06.2025, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim - Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “Mektrin Motors” SHPK.

III.1.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.06.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5466 dhe me nr. 1643/2025 prot, datë 24.06.2025, e operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK, por nga verifikimi i sistemit të ankesave elektronike nuk rezulton qe ky operator të ketë ngarkuar me attach në versionin pdf ankesën sipas formatit të duhur ligjor dhe mandat për kryerjen e pagesës për ankesën në fjalë, nga verifikimi i seksionit përshkrimi i ankesës të sistemit të ankesave elektronike rezulton se ky operator ekonomik ankimues kërkon shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt – ankimi si më poshtë vijon:

Objekti i ankesës	Shënime
Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj	

Brethanat dhe faktet Nisur nga njoftimit të fituesit me date 18/06/2025 per proceduren e prokurimit publik me Numri i Referencës së Lotit 2: REF-46106-04-25-2025 dhe objekt kontrate: Loti 2: "Marje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit" nga autoriteti kontraktor "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara", "Albania Motor Company" Sh.p.k kundërshton refuzimin e ofertes nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkrimi i shkeljeve të pretenduara Referuar argumentimit tuaj të skualifikimit si me poshte:
 "KVO argumenton se referuar legjislacionit sipas Kodit Civil, shitblerja nuk mund të konsiderohet e ngjashme me qerane. Shitblerja është një veprim juridik ku shitesit i humbet e drejta e sendit në favor të blerësit pasi ky i fundit paguan vlerën e plote të sendit, ndërsa në rastin e qeradhenies pronësia i mbetet shitesit të shërbimit i cili ka detyrimin të mirëmbaje në mënyrë të vazhdueshme sendin kundërt pageses të një shume mujore nga blerësi i shërbimit."
 Si dhe DST shtojca 8 Kriteret e Vecanta pika 2.3.1 është kërkuar si me poshte:
 b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi juaj bie në ndesh me kërkesat e DST e cila kërkon Faturat Tatimore të shitjes në sektorin privat. Në rast se do të kërkohej Faturat e dhenies me qera, Albania Motor Company do të bashkëlidhte keto fatura në kete procedure. Argumentimi juaj për skualifikimin e Albania Motor Company nuk qëndron dhe bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Neni 114 Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor pika 3. a) pranimin e plote të ankesës dhe skualifikimin e Albania Motor Company.

Me poshte do të gjeni referencat e faturave në sektorin privat me reference "Faturime_72_x_mjete". Sa me sipër KVO nuk mund të bëjë interpretime të cilat janë të pa kërkuara në DST nga njësitë e hartimit të dokumentave të kesaj procedure. Interpretimet e KVO janë në kundërshtim me rregullat dhe ligjin e Prokurimit Publik, dhe behen me qëllimin e vetëm për të favorizuar një operator të vetëm ekonomik i cili është fitues të dy loteve.

Albanian Motors Company kërkon nga komisioni i shqyrtimit të ankesave pranimin e ankesës sone për kete pike.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik:

Bazuar në argumentimin e paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), sipas të cilit pretendohet se kompania "Albania Motor Company" nuk disponon servis automjeteve, kjo pretendueshmëri nuk qëndron. Në kontratën për punë të ngjashme të dorezuar dhe në Lotin 1 midis AK "Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit" dhe BOE "Albania Motor Company" & "Antigone Rentals", në dokumentacionin e dorezuar gjendet e bashkëlidhur "Deklarata e Servisit të Autorizuar", e cila është hartuar në përputhje me kushte teknike edhe më të detajuara. Këto kushte janë përmbushur në mënyrë të plotë dhe rigoroze nga kompania "Albania Motor Company". Gjithashtu, në këtë kontratë paraqiten pamje të qarta që vërtetojnë se kompania disponon servisin e saj të automjeteve. Nga ana e Albanian Motor Company është paraqitur dhe kontrata e qerese ku në ushtrimeve aktivitetin, si për shitjen e makinave, dhenien me qera dhe servisin e tyre.
 Bazuar në Ekstraktin Historik të QKB në rubriken 9 "Objekti i aktivitetit" të shoqërisë Albania Motor Company evidentohet qarte dhenia me qera dhe ofrimi i servisit me të gjithë komponentet e tij. Kontrata e qerese e paraqitur nga ana jone është pikerisht prona ku Albania Motor Company ushtron aktivitetin, ku ka të përfshirë dhe servisin. Pavaresisht këtyre fakteve të paraqitura nga ne, KVO për të dalë në një konkluzion sa me të qarte, duhet të verifikonte në vend servisin para se të dilte në një konkluzion skualifikimi i cili rëndon buxhetin e shtetit me një vlerë prej afro 29 milion leke të reja.

Albania Motor Company disponon servisin e autorizuar prej 21 vitesh, dhe është e pa pranueshme që pas 21 viteve eksperience të sukseshme, duke ofruar shërbime për institucione shtetërore dhe private në shitjen, për makinat e dhëna me qera dhe të shitura prej nesh, të degjojme nga ana e KVO që nuk disponojmë servis.

Sa me sipër me të njëjtin dokumentacion argumentues për servisin Drejtorisë e Pergjithshme e Policisë së Shtetit na ka kualifikuar dhe kemi lidhur kontratën për marje makina me qera, ndërsa po për të njëjten procedure të ngjashme, dhe po për llogari të Drejtorisë së Pergjithshme të Policisë së Shtetit, KVO-se për KVO nuk plotësojmë kriteret.

Me poshte do të gjeni dhe pjesë nga Ekstrakti Historik i QKB në rubriken 9. "Objekti i aktivitetit".

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik Neni 114 Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor pika 3. a) pranimin e plote të ankesës dhe skualifikimin e Albania Motor Company.

Albanian Motors Company kërkon nga komisioni i shqyrtimit të ankesave pranimin e ankesës sone për kete pike
 Në Ekstraktin Historik të QKB që kompania ka vënë në dispozicion është e shprehur qarte ofrimi i shërbimeve. Në faqen nr.1 pika 9 Objekti i aktivitetit :qiramarrjen apo qiradhenien , gjithashtu dhe në faqen nr.2 pika 9 Objekti i aktivitetit: Riparim automjeteve të të gjitha llojeve përfshirë kamionë dhe mjetet e rënda të punës, mirëmbajtjen dhe kontrollin teknik të automjeteve të ndryshme, përfshirë automobilat, kamionët, traktorët, ekskavatorët, autobusët dhe mjeteve të tjera të transportit, si dhe riparimin e sistemeve motorike, të frenimit, elektrike, hidraulike, mekanike, të drejtimit dhe të ngjashme. Shërbime për lyerjen e automjeteve të të gjitha llojeve, përfshirë përdorimin e teknologjive moderne të lyerjes, riparimin e dëmeve të karrocisë, trajtimin e sipërfaqeve të ndryshme të automjeteve, si dhe përdorimin e bojërave dhe materialeve

Skualifikimi jone është bere për të favorizuar po të njëjten kompani si në Lotin 1 ashtu dhe në Lotin 2 ku pavaresisht se ka ndryshuar emrin ka po të njëjtet Aksionere. Duket qarte se KVO nuk ka vlerësuar duke u bazuar në dokumentacionin ligjor por në cmimin me të larte. Demi Ekonomik i shkaktuar shteti dhe taksapaguesve Shqiptarë në të dy procedurat është afro 57 milion leke të reja.

KVO duhet të konstatojë faktin se i njëjti prodhues ka marrë pjesë në kete procedure prokuruese me dy kompani të ndryshme ku në vend se të skualifikonte të dy kompanite, në kundërshtim të hapur me ligjin ka kualifikuar njërën, duke e shpallur dhe fituese.

Me keqardhje konstatojmë faktin se vlersimi për kete procedure prokuruese nga anëtarët e KVO, ka qenë i njëanshem dhe fituesi ka qenë i paracaktuar.

Nga KVO jane shkelur Nene te Kodit Penal, Neni 248 "Shperdorimi i Detyres", Neni 258 "Shkelja e barazise se pjesemarresve ne tendera apo ankande publike" dhe Neni 25 "Kuptimi i bashkepunimit"

Bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik Neni 76 Kriteret detyruese për skualifikim pika 3. "Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;" ku MEKTRIN MOTORS dhe PORSCHE LEASING kane autorizim prodhuesi nga i njeiti prodhues per Lotin 1 dhe Lotin 2 .

Sa me siper duke konstatuar me qendardhe se te gjitha anetaret e KVO duke na skualifikuar, kane shkelur hapur barazine e pjesemarresve ne tendera apo ankande publike duke shperdoruar detyren. Sa me siper Albanian Motor Company do te ndjeki te gjitha rruget administrative dhe ligjore per te vene para pergjegjese ligjore personat qe kane shperdoruar detyren ne kete procedure prokuruese.

Sa me siper bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik Nr.162 date 23/12/2020 " PER PROKURIMIN PUBLIK" kerkojme pranimin e plote te ankeses dhe kualifikimin si oferte e sukseshme e Albania Motor Company per kete procedure prokuruese.

Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Kërkesë për ekspertizë ☒
të posaçme

Specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon ☐ Te Verifikohet nga nje ekspert i fushes pjesa e disponueshmerise se Servisit prane ambienteve te Albania Motor Company

Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do merren me shqyrtimin e ankesës

Kërkesë për përjashtim ☐ N/A
të zyrtarëve

Lista e informacionit konfidencial

Lista e informacionit konfidencial ☐ N/A

Keni paraqitur paraprakisht ankesë pranë Autoritetit Kontraktor?

III.1.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 dhe 4/b të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1643/1 prot., datë 25.06.2025, u publikuan arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” SHPK, kundërshton nëpërmjetë ankesës nr. 1643/2025, datë 24.06.2025.

III.1.8. Më shkresën nr. 1198/12 prot, datë 02.07.2025 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Motor Company” shpk, lidhur me vleresimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-46106-04-25-2025, me objekt Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1643/2 prot, datë 03.07.2025, rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës, nga verifikimi i së cilës rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues nuk është pranuar me argumentat si më poshtë vijon:

Ne datën 24.06.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nepermjet sistemit te ankesave elektronike te Komisionit te Prokurimit Publik nepermjet portalit e-Albania, prane Komisionit te Prokurimit Publik me numer protokolli 1641/2025, date 24.06.2025 dhe Nr aplikimi te ankesës online: A/2025/5464, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar qe vërteton pagesen e tarifës perkatese per ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur) si dhe nuk është paraqitur formulari i ankesës.

Ne nenin 111 “Paraqitja e ankeses” te ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Operatori ekonomik ankimues dergon njekohesisht ankesen ne autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik ne Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla te posame per mënyren e paraqitjes se ankeses percaktohen ne rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa behet sipas formularit perkates, ku shenohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për proceduren konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon per shkeliet, pagesa e tarifës se ankeses, duke e shoqeruar atë me dokumentacionin dhe provat perkatëse, per te cilat mendon se mbështetin ankimin e tij. Elementet e siperpermendura jane te domosdoshme per shqyrtimin e ankeses. Ankimuesi eshte i detyruar t'i bashkelidhe ankimit dokumentin bankar qe verteton pagesen e tarifës perkatese per ankesën.
3. Nese mungon ndonje nga elementet e siperpermendura ose formulari nuk eshte plotesuar në mënyren e duhur, atehere autoriteti ose enti kontraktor duhet të vere ne dijeni ankimuesin per te plotesuar formularin. Njoftimi mund te behet me cdo mjet te mundshem, perfshire edhe posten elektronike, dhe ne cdo rast dokumentohet. Nese ankesa nuk korrigjohet brenda 2 diteve nga njoftimi, ajo vleresohet si e paraqitur.
4. Në çdo rast, paraqitja e ankeses shoqerohet me mandatpagesën e bere prane Komisionit te Prokurimit Publik.

Referuar bases ligjore te sipercituar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës, me anë te rubrikes “Kërkese per informacion OE” nepermjet sistemit te ankesave elektronike, ne date 25.06.2025 dergoi kerkesen per plotesimin e mangesive te konstatuara lidhur me dokumentin bankar qe vërteton pagesën e tarifës perkatese per ankesen si dhe me vete formularin e ankeses. Plotesimi i ketyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy diteve nga njoftimi.

Duke mbajtur ne konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nenshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në te cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje ne thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit ne themel të ankimit, ne rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund te konsiderohet si ezaurim i formës se ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshem ligjore që duhet te permbajë nje ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Per sa më siper, KSHA gjykon se perderisa operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotesoje mangesite e konstatuara lidhur me elementët permbajtësore të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

Per Këto Arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albania Motor Company” shpk.
2. Personi përgjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi përgjegjës per prokurimin te njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites se nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

4. *Personi pergjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
5. *Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qendror Blerës.*

III.1.9. Nga verifikimi i sistemit të ankesave elektronike konkretisht rubrikës komunikime rezulton se më datë 25.06.2025, autoriteti kontraktor, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike i është drejtuar operatorit ekonomik ankimes me kërkesë për korrigjim të metash me përmbajtje si më poshtë vijon:

Inderuar Operator Ekonomik "ALBANIA MOTOR COMPANY" me Nipt K41829010I, Më datë 28.04.2025 Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në cilësinë e organit qendror blerës ka shpallur në sistemin e prokurimit elektronik të APP procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me objekt: "Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit" me nr. REF-46106-04-25-2025. Më datë 24.06.2025, është administruar ankesë, në sistemin elektronik të ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5466 për procedurën e prokurimit të sipërcituar, nga ku rezulton se është paraqitur dokumentacioni shoqërues që mbështesin ankimin e tuaj por nuk është paraqitur Formulari i Ankesës ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet si dhe dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Për sa më sipër dhe referuar parashikimeve të pikës 2 dhe 3, të nenit 111 të LPP, të ndryshuar: 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. 3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Iutemi për plotësimin e mangësisë së konstatuar mbi paraqitjen e formularit të ankesës si dhe pagesën e mandatit lidhur me ankesën e sipërpërmendur. Në rast se korrigjimet e mësipërme nuk do të bëhen brenda dy ditëve, ankesa me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5466, do të vlerësohet si e pa paraqitur. Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin		
Korrigjim i të metave të ankesës	25/06/2025 09:40:48	M41501042N - Operatori i Blerjeve të Përqëndruara

III.1.10. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me memon nr. 1643/3. prot, datë 08.07.2025, me objekt "*Kërkesë për verifikim pagese*" Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së, duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon:

Në datë 24.06.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5466 dhe me nr. 1643/2025 Prot., date 24.06.2025 e operatorit ekonomik "Albania Motor Company" SHPK, për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", me objekt Loti 2 "Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit" me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

*Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, statusi i pagesës për ankesën me numër 1643 prot., datë 24.06.2025 rezulton "**Paparaqitur mandat pagesë**".*

Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën me numër 1643/2025 prot., datë

24.06.2025, paraqitur nga operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.11. Më memon nr. 1643/4 prot, datë 19.07.2025 me objekt “Kthim përgjigje”, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, pas verifikimeve të kryera informon si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr.1643/3 prot., datë 08.07.2025, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.1643/2025 prot., datë 24.06.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/5466, Operatori ekonomik “Albania Motor Company” SHPK rezulton se nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.

Referuar raportit të dërguar më datë 09.07.2025 nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera për muajin Qershor- Korrik 2025, rezulton se Operatori Ekonomik “Albania Motor Company” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.

III.1.12. Në nenin 111, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.13. Në nenin 33 “Formulari i ankesës”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

“Kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit dhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.”

Gjithashtu në nenin 94 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

“3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

III.1.14. Në dokumentet standarde të tenderit, në Seksionin IV parashikohet: “Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.” Gjithashtu në “Shtojcën 20” të dokumenteve standarde të tenderit është publikuar “Formulari i ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.15. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.16. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.17. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e

prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.18. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.19. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.20. Në nenin 97 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet:

“2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.21. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “*Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me

ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Në nenin 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.22. Së pari, nga verifikimi i sistemit të ankesave elektronike rezulton se ankimuesi nuk ka ngarkuar me attach në formatin pdf ankesën sipas formatit të duhur ligjor të firmosur dhe vulosur nga administratori, gjithashtu nga shqyrtimi i seksionit përshkrimi i ankesës të sistemit të ankesave elektronike rezulton se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, konstatohet se, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Motor Company” SHPK nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj, pasi nuk është paraqitur sipas formularit standard të ankesës të miratuar dhe të publikuar në dokumentet standarde të tenderit, si dhe nuk është dorëzuar bashkëlidhur mandatpagesa, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Theksojmë, se në zbatim të nenit 33 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankese pranë këtij të fundit dhe njëherësh pranë

Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

Gjithashtu, në Shtojcën 20 të dokumenteve standarde të tenderit pasqyrohet formulari standard i ankesës që operatorët ekonomikë mund të paraqesin pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me pretendimet e tyre.

Akoma më tej, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

III.1.23. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues “*Albania Motor Company*” SHPK nuk ka respektuar formën e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik sipas kërkesave ligjore dhe atyre të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Aktet e prodhuara nga një person juridik privat, duhet të përmbajnë të gjitha elementet thelbësore, që i bejnë ato të vlefshme si nga ana formale dhe ajo materiale. Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të aktit ankimi elektronik A/2024/5466 dhe me nr. 1643/2025 prot., datë 24.06.2025, e operatorit ekonomik “*Albania Motor Company*” SHPK, i cili është i një rëndësie të veçantë në një procedurë prokurimi, gjykon se kjo ankesë nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe legjislacioni në fuqi, të cilat janë të detyrueshme të përmbushen nga ankimuesi, në të gjithë elementet që përmban ajo, përfshirë formën sipas formularit standard të miratuar si dhe pagesën e tarifës përkatëse për ankimin. Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është forma dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i anës formale, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (*në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit*) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit (*nëse kërkesa përmbush elementet formale, Komisioni vazhdon me shqyrtimin në themel të saj*), në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk përmbush elementet formale, edhe pas kërkesës së autoritetit kontraktor nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike për korrigjimin e të metave, për faj të vetë ankimuesit, ndaj dhe mungesa e kushteve formale përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e KPP-së.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një

procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albania Motor Company” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt Loti 2 “Marrje autovetura SUV me qira për policinë e shtetit” me Nr. REF-46106-04-25-2025, me fond limit: 227,800,627.20 (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë njëzet) lekë pa TVSH ose 2,307,309.10 (dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e nëntë pikë dhjetë) euro pa TVSH., zhvilluar në datën 28.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

